

From: hamdi aliu

Sent: Tuesday, May 27, 2025 9:59 AM

To: urbanizmi prishtine

Subject: Koment ne lidhje me kerkesen 05 Nr. 350/02-103314/24 dt. 07.08.2024

Pershendetje,

Po ju shkruaj ne lidhje me kerkesen 05 Nr. 350/02-103314/24 dt. 07.08.2024 te paraqitur nga grup pronaresh dhe investitori Nura group- shpk, me te cilen kerkohet nga Kouma e Prishtines te percaktohen kriteret e caktuar per ndertim te ndertesave shume banesore dhe afariste ne kuader te parcelave kadastrale nr. 1875-0 dhe 757-2 Z.K Matiqan.

Ne lidhje me kete qeshtje, ne banoret e objekteve banesore nr. 1, 2 dhe 3 te ndertesave Nura group, jemi mjaft te shqetesuar dhe qysh ne vitin 2021 kemi qene te njoftuar jo zyrtarisht se kompania Nura Group eshte duke pergatitur dokumentacionin teknik me qellim te parashtrimit apo edhe e ka parashtruar kerkesen ne Komunen e Prishtines, ne sektorin e urbanizmit per leje ndertimore per ndertimin e objektit banesor dhe lokale afariste, brenda hapësirave te objekteve te kompleksit Nura Group, saktësisht ne hapësirën e parkingut te automjeteve te këtyre banesave. Prandaj ne banoret, qysh atehere, jemi takuar dhe kemi diskutuar ku edhe kemi marr menshkrimet nga banoret duke kundërshtuar kategorikisht kete qeshtje, ku edhe kemi parashtruar kerkese te protokoluara me emrin: **"Lënda: Kërkese për mos lëshimin e lejes ndërtimore ne kompleksin banesore Nura Group , Ndue Perlleshi, Prishtine"**

Drejtuar KOMUNES SE PRISHTINES – Sektorit te urbanizmit,
Drejtorit te Drejtorisë: Ardian Olluri,
CC Kryetarit te komunës: Z. Shpend Ahmeti, dhe Drejtorit te inspeksionit: Z. Adonis Tahiri.

Kërkesa perfshine te bashkëngjitur edhe;

1. Listën me nënshkrimet e pronareve.
2. Foto nga Google map te lagjes Nura Group.
3. 2 foto te marr nga Facebook faqja Nura group

Prandaj per kete qeshtje ju lutem rishiqoni kerkesen e protokoluara, ne mars te vitit 2021
ku edhe e gjeni komentet e banoreve te lagjes.

Pune te mbare.